



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 467/10 prot.

Tiranë, më 24.06.2021

**VENDIM**

**Nr.80, datë 24.06.2021**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT  
TË KOMISIONERIT NR. 45, DATË 27.04.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 45, datë 27.04.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 606/2, datë 12.4.2021, për mosmiratimin e kërkesës për pezullim për një afat 3-mujor të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 467 prot., datë 14.04.2021, nga nëpunësi \*\*\*\*\* është ngritur pretendimi se, nga ana e institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil është vepruar në mënyrë të parregullt në lidhje me konstatimin e shkakut të pezullimit të marrëdhënies së tij të punës për një afat 3-mujor, duke mos e miratuar kërkesën e tij në këtë rast.

Nëpërmjet shkresës nr. 606 prot., datë 12.04.2021, “Kërkesë për pezullim nga shërbimi civil për një afat 3-mujor”, punonjësi në fjalë ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil për një periudhë 3-mujore, për arsye trajnimi dhe arsimimi pranë Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Byroja Kombëtare e Hetimit, e vërtetuar me aktin nr. 56 prot., datë 06.04.2021, të këtij organi.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 45, datë 27.04.2021, të Komisionerit, “*Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr.606/2, datë 12.04.2020, për mosmiratimin e kërkesës për pezullim për një afat 3-mujor të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.*”

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Autoritetit të Aviacionit Civil ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.45, datë 27.04.2021, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në Autoritetin e Aviacionit Civil paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse në Autoritetin e Aviacionit Civil për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, të veprojë sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr.45, datë 27.04.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Konkretisht, Komisioneri ka kërkuar nga organi publik, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil, që pasi të konstatojë paligjshmërinë e aktit nr. 606/2, datë 12.04.2021, “*Kthim përgjigje ndaj kërkesës për pezullim 3-mujor, shkresa nr.606, datë 12.4.2021*”, ta anulojë atë dhe pas kësaj të nxjerrë aktin përkatës, duke konstatuar si të ligjshëm shkakun e pezullimit për një afat 3-mujor për nëpunësin \*\*\*\*\*.

Vërej se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 45, datë 27.04.2021, Autoriteti i Aviacionit Civil, me shkresën nr.712/5 prot., datë 27.04.2021, ka konstatuar ligjshmërinë e shkakut të pezullimit, si dhe ka miratuar pezullimin nga shërbimi civil për një afat 3-mujor për nëpunësin \*\*\*\*\*.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 45, datë 27.04.2021, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr.606/2, datë 12.04.2021, për mosmiratimin e kërkesës për pezullim për një afat 3-mujor të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gejdjes”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.45, datë 27.04.2021.
3. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti i Aviacionit Civil.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**